



SHTYLLA II ÇËSHTJE PRAKTIKE & ADMINISTRATIVE

Bashkimi ndërkufitar i Shoqërive Tregtare
Nga MSc Enea Sheqi

I. ABSTRAKT

Shoqëritë tregtare në Shqipëri luajnë një rol të rëndësishëm, por burimet tona duke qenë se janë të konsiderueshme mund të luajnë rol dhe në tregun europian . Në kuadër të përafrimit të legjislacionit shqiptar me atë europian Shqipëria ka miratuar ligjin për bashkimin ndërkufitar të shoqërive tregtare me qëllim që të përcaktojë hapat dhe procedurat e bashkimit të shoqërive tregtare shqiptare me ato europiane. Ky bashkim krijon kushtet për një konkurrencë më efektive dhe një treg më të përbashkët efikas, prandaj në këtë punim do të trajtojmë disa nga konceptet bazë të bashkimit ndërkufitar, format e këtyre bashkimeve, pasojat ligjore dhe efektet që ajo sjell në ekonominë e brendshme dhe atë europiane. Një fokus i veçantë i kushtohet edhe mbrojtjes së interesave të punëmarrësve që janë edhe subjektet që preken më shumë nga ky ligj.

Fjalët Kyçe: *tregu europian, shoqëritë tregtare shqiptare, bashkim ndërkufitar, punëmarrës*

SHKURTIME:

BE	Bashkimi Europian
LSHT/Ligji Nr.9901	“Për Tregëtarët dhe shoqëritë tregëtare” i ndryshuar .
LBNSHT/Ligji Nr.110/2012	Ligji “ Për bashkimin ndërkufitar të shoqërive tregtare”.
QKR/QKB	Qendra Kombëtare e Regjistrimit/Qendra Kombëtare e Biznesit

II. HYRJE

Tregëtia europiane mbështetet në parimin e zhvillimit të një tregu të përbashkët me një kuadër ligjor eficient dhe efektiv.¹ Subjektet tregtare që marrin pjesë në shitjen, shkëmbimin, furnizimin dhe prodhimin tregtar veprojnë si në përputhje me legjislacionin e brendshëm ashtu edhe me atë europian. Duke vepruar në këtë mënyrë, në kuadër të legjislacionit europian, shtetet në bashkëpunim me institucionet e BE-së kanë ofruar disa zgjidhje artificiale për të rritur bashkëpunimin ekonomik ndërmjet shteteve anëtare, duke krijuar kështu struktura të reja tregtare si shoqëritë europiane, grupet ekonomike të interesit, korporatat europiane etj.

¹ Zajmi,I., *E drejta Europiane*, OMBRA GVG,Tiranë 2010, fq.16.



ALBANIA

Law Journal

ISSN 2523-1774

LAWJOURNAL.AL

Numri 6

Prill 2018

Ideja për hartimin e një direktive e cila do të përfronte legjislacionin e shteteve anëtare të BE-së në drejtim të bashkimit ndërkufitar të shoqërive tregtare daton që në vitin 1984, por vetëm në vitin 2005 u finalizua. Ajo u transpozua në shtetet anëtare në vitin 2007 për shkak të divergjencave që ekzistonin ndërmjet shteteve anëtare për sistemin e përfshirjes së punëmarrësve në organet drejtuese të shoqërisë.

Nevoja e harmonizimit e legjislacionit të shteteve anëtare të BE-së ishte për të lehtësuar dhe rritur qarkullimin tregtar, për të lehtësuar procedurat e bashkimeve të shoqërive tregtare, për të reduktuar kostot dhe për të rritur transparencën. Gjithashtu, Gjykata Europiane e Drejtësisë në praktikën e saj² e kishte përcaktuar se refuzimi i bashkimit të shoqërive tregtare të shteteve të ndryshme, në një shtet anëtar, në rastet kur marrëveshja e bashkimit ishte në përputhje me legjislacionin vendas përbënte një cenim të lirisë së themelimit.

Direktiva 2005/56³ e Bashkimit European jep një zgjidhje për të gjitha shoqëritë tregtare që duan të bashkëpunojnë dhe të shtrijnë veprimtarinë e tyre jo vetëm në tregun e brendshëm por edhe në ate europian. Direktiva në këtë mënyrë ka ofruar një kornizë ligjore të saktë dhe zgjidhje praktike për këto lloj marrëdhëniesh tregtare në kuadër të funksionimit në mënyrë sa më efektive të tregut europian.⁴

Shqipëria në rrugën e saj të gjatë për t'u bërë pjesë e familjes së madhe europiane, me shpresën e madhe për një integrim të afërt, ka inkorporuar këtë direktivë në legjislacionin e saj të brendshëm me ligjin Nr. 110/2012 "Për Bashkimin Ndërkufitar të Shoqërive Tregtare". Në këtë mënyrë i është hapur rruga krijimit të formave të reja të bashkëpunimit tregtar duke marrë masa paraprake për t'u përgatitur për të hyrë në këtë treg të ri e të panjohur nga ana jonë, në një të ardhme sa më të afërt.

Qëllimi i Ligjit Nr. 110/2012 është përcaktimi i kushteve, procedurave dhe pasojave juridike të një bashkimi ndërkufitar ndërmjet shoqërive shqiptare dhe shoqërive europiane, si dhe parashikimi i masave mbrojtëse për punëmarrësit dhe kreditorët e këtyre shoqërive.⁵ Me anë të këtij ligji i jepet mundësi për një mbrojtje më të madhe kreditorëve dhe punëmarrësve por rregullohen gjithashtu shumë pasoja që mund të vijnë si rezultat i bashkimit. Përjashtim i veçantë

² Sevic Systems AG, Çështja C-411/03, Gjykata Europiane e Drejtësisë.

³ Direktiva 2005/56/KE të Parlamentit European dhe të Këshillit, datë 26 tetor 2005 "Për Bashkimin Ndërkufitar të Shoqërive me Përgjegjësi të Kufizuar". Numri CELEX: 32005L0056, Fletorja Zyrtare e Bashkimit European, Seria L, Nr. 310, datë 25.11.2005, faqe 1 - 9.

⁴ Study on the Application of the Cross-Border Mergers Directive, International Policy Studying, 2013, fq.5.

⁵ Neni 1 i Ligjit Nr. 110/2012 "Për Bashkimin Ndërkufitar Të Shoqërive Tregtare".



ALBANIA

Law Journal

ISSN 2523-1774

LAWJOURNAL.AL

Numri 6

Prill 2018

i ligjit është fakti që nuk përfshihen në këto bashkime, bashkimet e shoqërive me kapital të përbërë nga investimi kolektiv i publikut, por vetëm bashkimi i shoqërive me kapital privat.⁶

III. BASHKIMI NDËRKUFITAR I SHOQËRIVE TREGTARE

Një shoqëri tregtare mund të ndryshoj formën e saj ligjore nëpërmjet riorganizimit të saj. Ajo mund të shndërrohet në një formë tjetër ligjore, si për shembull nga një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar në atë anonime/aksionare, ajo mund të ndahet ose të bashkohet. Në fokus të këtij punimi është bashkimi ndërkufitar i shoqërive tregtare shqiptare dhe atyre europiane, por udhëhequr jo thjesht nga legjislacioni shqiptar, por gjithashtu nga legjislacioni evropian.

Sipas LTSHT, në përgjithësi, bashkimi i shoqërive tregtare mund të ndodh në dy mënyra⁷: a) nëpërmjet bashkimit me përthithje që konsiston në kalimin e të gjitha aktiveve e pasiveve të njëres ose më shumë shoqërive, që quhen shoqëritë e përthithura, tek një shoqëri tjetër ekzistuese, e quajtur shoqëria përthithëse, në këmbim të aksioneve apo kuotave të kësaj shoqërie, b) ose nëpërmjet themelimit të një shoqërie të re, tek e cila kalohen të gjitha aktivet e pasivet e shoqërive ekzistuese, që bashkohen në këmbim të aksioneve apo kuotave të shoqërisë së re, i cili quhet bashkim me krijimin e një shoqërie të re.⁸ Riorganizimit të formës së saj ligjore LTSHT-ja njeh vetëm dy formave të shoqërisë, shoqërive me përgjegjësi të kufizuar dhe shoqërive anonime/aksionare.

Bashkim ndërkufitar i shoqërive tregtare nga ana tjetër është bashkimi ndërmjet një ose më shumë shoqërive shqiptare dhe një a më shumë shoqërive europiane.⁹ Shoqëri europiane konsiderohet një shoqëri tregtare me selinë e regjistruar, zyrën qendrore apo vendndodhjen kryesore të veprimtarisë në territorin e një vendi evropian, e cila ka formën ligjore të përcaktuar sipas Direktivës 2005/56 "Për Bashkimin Ndërkufitar të Shoqërive me Përgjegjësi të Kufizuar". Bashkimi ndërkufitar i shoqërive tregtare mund të realizohet në disa mënyra dhe përkatësisht kur¹⁰:

- a) një ose më shumë shoqëri tregtare prishen pa kaluar në procesin e likuidimit në gjendjen e aftësisë paguese (shoqëria objekt), duke transferuar të gjitha aktivet dhe pasivet e veta në favor të një shoqërie tjetër tregtare ekzistuese (shoqëria përthithëse), në këmbim të emetimit në favor të ortakëve/aksionarëve të Shoqërisë Objekt, të titujve apo aksioneve/kuotave të kapitalit të Shoqërisë Përthithëse dhe, nëse është e zbatueshme, të një pagese në mjete

⁶ Neni 2 i LBNSHT.

⁷ Malltezi, A., *E Drejta Shqiptare e Shoqërive Tregtare*, Mediaprint, Tiranë, 2011, fq.270.

⁸ Neni 215 i Ligjit Nr.9901, "Për Tregëtarët dhe Shoqëritë Tregëtare" i ndryshuar.

⁹ Neni 3/2 i LBNSHT.

¹⁰ Neni 3 i LBNSHT.



monetare, e cila nuk është më e madhe se 10 për qind e vlerës nominale ose, në mungesë të vlerës nominale, të vlerës kontabël të këtyre titujve apo aksioneve/kuotave të kapitalit; ose

- b) dy a më shumë shoqëri tregtare prishen pa kaluar në procesin e likuidimit në gjendjen e aftësisë paguese (shoqëria objekt), duke transferuar të gjitha aktivet dhe pasivet e veta në favor të një shoqërie tjetër tregtare të themeluar rishtazi (shoqëria e re), në këmbim të emetimit për ortakët/aksionarët e shoqërisë objekt të titujve apo aksioneve/kuotave të kapitalit të shoqërisë së re dhe, nëse është e zbatueshme, të një pagese në mjete monetare, e cila nuk është më e madhe se 10 për qind e vlerës nominale ose, në mungesë të vlerës nominale, të vlerës kontabël të këtyre titujve apo aksioneve/kuotave të kapitalit; ose
- c) një shoqëri tregtare, pas prishjes, pa kaluar në procesin e likuidimit në gjendjen e aftësisë paguese (shoqëria objekt), i transferon të gjitha aktivet dhe pasivet e veta në favor të shoqërisë tregtare, e cila zotëron të gjithë titujt apo aksionet/kuotat e kapitalit të shoqërisë që priset (shoqëria përthithëse).

Ligji shqiptar i BNSHT i njeh mundësinë e realizimit të bashkimeve vetëm dy subjekteve tregtare, shoqërive aksionare dhe atyre me përgjegjësi të kufizuar.¹¹ Ky parashikim ligjor është bërë dhe me qëllim për të përafuar legjislacionin tonë me Direktivën 2005/56 "Për Bashkimin Ndërkufitar të Shoqërive me Përgjegjësi të Kufizuar".

Veçori e bashkimeve ndërkufitare është procedura, e cila është një procedurë relativisht e re dhe më shumë formale. Procedura e bashkimit nis me hartimin e projekt marrëveshjes me shkrim nga ana e përfaqësuesve ligjorë të shoqërive që synojnë të bashkohen. Në këto marrëveshje përcaktohen kushtet e përbashkëta si: forma e shoqërisë, emri, selia, adresa, aktiviteti i tyre tregtar, raporti i zbatueshëm për këmbimin e titujve apo aksioneve/kuotave të kapitalit të shoqërisë dhe vlera e pagesës në mjete monetare, statuti i shoqërisë përthithëse etj.¹²

Përkrah kësaj marrëveshje përfaqësuesit e shoqërive duhet të hartojnë dhe një raport të hollësishëm ku të tregohen: Përfaqësuesit ligjorë të secilës shoqëri shqiptare pjesëmarrëse duhet të hartojnë një raport të hollësishëm, ku të shpjegohet marrëveshja e bashkimit dhe të përshkruhen bazat ligjore dhe ekonomike të saj, në veçanti, raporti i këmbimit të aksioneve, kuotave apo të drejtave të veçanta. Në këtë raport duhet të përshkruhen edhe vështirësitë që janë hasur, lidhur me vlerësimet e kryera, si dhe pasojat që do të ketë bashkimi ndërkufitar mbi ortakët/aksionarët, kreditorët dhe punëmarrësit e shoqërive pjesëmarrëse.¹³

¹¹ Nenet 3-10 të Ligjit Nr. 110/2012 "Për Bashkimin Ndërkufitar Të Shoqërive Tregtare".

¹² Neni 5, po aty.

¹³ Neni 6, ibid.



ALBANIA

Law Journal

ISSN 2523-1774

LAWJOURNAL.AL

Numri 6

Prill 2018

Përfaqësuesit ligjorë të secilës shoqëri shqiptare pjesëmarrëse caktojnë një a më shumë ekspertë të pavarur, të licencuar, për të shqyrtuar kushtet e përbashkëta të projekt marrëveshjes së bashkimit ndërkuftar. Në deklaratën e tyre ekspertët duhet të shprehen dhe të përshkruajnë, të paktën: i) metodën ose metodat që janë përdorur për të arritur në raportin e propozuar të këmbimit të aksioneve/kuotave; ii) nëse kjo metodë apo këto metoda janë të përshtatshme për rastin në fjalë, të tregojnë vlerat e arritura përmes përdorimit të metodës dhe të japin një mendim për rëndësinë relative që i jepet secilës metodë për të arritur në vlerën e përcaktuar; iii) vështirësitë e veçanta të hasura gjatë vlerësimit.¹⁴ Pra në këtë mënyrë organet e shoqërisë i kushtojnë një vëmendje edhe pasojave ekonomike që do të sjellë marrëveshja, të njëjtën vëmendje që i kushtojnë (mutatis mutandis) dhe pasojave ligjore. Para mbledhjes së asamblesë së përgjithshme, administratorët e shoqërive tregtare shqiptare bëjnë publikimin e projekt marrëveshjes dhe raporteve në QKR/QKB. Publikimi bëhet për arsye njohjeje nga ana e personave të tretë.¹⁵

Organi që ka rolin kryesor në procedurën e bashkimit ndërkuftar të shoqërive tregtare është asambleja e përgjithshme¹⁶ Me miratimin e projekt marrëveshjeve të cituara më sipër dhe raporteve të ekspertëve kontabël si dhe kushteve të bashkimit i hapet rrugë kësaj strukture të re ndërkombëtare. Për këtë lloj vendimi asambleja ka nevojë të vendosë me 3/4 pra me një shumicë të cilësuar, kjo dhe për shkak të efekteve që vendimi sjell. Kur nga ky bashkim preken aksionarët me të drejta të veçanta nevojitet dhe një miratim prej tyre. Ky proces mbaron me regjistrimin e këtij vendimi në QKR/QKB.

Në rastet e bashkimeve ndërkuftare të shoqërive tregtare e nevojshme është dhe certifikata e parabashkimit. Certifikata e parabashkimit është deklarata e redaktuar nga noteri i autorizuar, në bazë të kërkesave të ligjit shqiptar, me kërkesë të përfaqësuesit ligjor të shoqërive shqiptare pjesëmarrëse në bashkim, që vërteton përmbushjen e kushteve juridike të parabashkimit ndërkuftar. Ky është një instrument që në legjislacionin tonë është në kompetencë të noterit, me anë të së cilës përcaktohen nëse janë përmbushur ose jo kushtet e parabashkimit nga të gjitha shoqëritë.¹⁷ Gjatë bisedimeve në kuadër të miratimit të kësaj dispozite ka pasur debat se kush do të ishte organi përgjegjës për dhënien e certifikatës së parabashkimit. Shumë prej vendeve europiane si p.sh Franca kishin pranuar gjykatën si lëshuesen e kësaj certifikate, ndërsa vende të tjera ishin të ndara ndërmjet opsionit të noterëve apo organeve të reja të krijuara për këtë qëllim. Shqipëria e gjendur përballë kësaj dileme vendosi t'i japë një rol të gjerë noterëve duke vepruar

¹⁴ Neni 7, ibid.

¹⁵ Neni 8, ibid.

¹⁶ Neni 9 i LBNSHT.

¹⁷ Neni 10 i LBNSHT.



në të njëjtën mënyrë si disa vende si disa vende të tjera si për shembull Holanda¹⁸, por duke u bërë dhe subjekt i kritikave të shumta për shkak se noterët do të kenë kompetenca të gjëra dhe mund të abuzojnë. Përsa i përket mendimit të autorit lidhur me këtë çështje, kjo e drejtë duhet t'i takonte gjykatës pasi ajo është organi kryesor që mund të vendosë për vlefshmërinë ose jo të kushteve të ndryshme ligjore ex-officio.¹⁹

Me dhënien e certifikatës dhe regjistrimin në QKR/QKB të kësaj shoqërie, ajo (shoqëria) fiton dhe personalitetin juridik të saj, pra nga ky moment shoqëria është e aftë të konsiderohet si subjekt i së drejtës dhe të marrë përsipër të drejta dhe detyrime. Vlen të përmendet edhe bashkimi me procedurë të thjeshtëzuar.²⁰ Sipas tij nëse shoqëria përthithëse është shoqëri shqiptare, e cila zotëron 90 për qind ose më shumë, por jo të gjitha kuotat ose aksionet me të drejtë vote në asamblenë e përgjithshme të shoqërisë/shoqërive objekt, hartimi i raporteve të ekspertëve të pavarur dhe dokumentacioni tjetër i nevojshëm për shqyrtimin e kushteve të bashkimit ndërkufitar, janë të detyrueshme **vetëm kur këto dokumente kërkohen nga ligji i zbatueshëm në vendin europian, në territorin e të cilit është vendosur shoqëria objekt europiane**. Pra nëpërmjet këtij parashikimi ligjor, eliminohen disa procedura duke e bërë më të thjeshtë bashkimin ndërkufitar.

IV. EFEKTET LIGJORE TË BASHKIMIT NDËRKUFITAR

Siç e kemi parë deri më tani bashkimi ndërkufitar mund të ndodh në dy mënyra, e para me anë të transferimit të aseteve tek shoqëria ekzistuese ose me anë të krijimit të një shoqërie të re (New Co). Bashkimi ndërkufitar, prodhon disa efekte ligjore nëse kemi transferimin e aseteve tek një shoqëri përthithëse²¹ që janë:

- a) të gjitha aktivet, të drejtat dhe detyrimet e shoqërisë objekt bashkimi i kalojnë menjëherë shoqërisë përthithëse, pavarësisht kërkesave ligjore për kryerjen e formaliteteve të posaçme, të cilat në çdo rast kanë efekt deklarativ;
- b) ortakët ose aksionarët e shoqërisë objekt bashkimi bëhen ortakë ose aksionarë të shoqërisë përthithëse
- c) shoqëria objekt bashkimi konsiderohet e prishur. Nëse shoqëria objekt bashkimi është shoqëri shqiptare, atëherë ajo çregjistrohet menjëherë nga QKR/QKB-ja, në bazë të

¹⁸ <https://www.clearygottlieb.com/~media/cgsh/files/neës-pdfs/implementation-of-the-cross-border-merger-directive-in-the-netherlands.pdf>

¹⁹ E drejta që i takon institucionit vetëm nga qënia si i tillë.

²⁰ Neni 15 i LBNSHT.

²¹ Neni 13 i LBNSHT.



ALBANIA

Law Journal

ISSN 2523-1774

LAWJOURNAL.AL

Numri 6

Prill 2018

parashikimeve të ligjit të posaçëm që rregullon organizimin dhe funksionimin e këtij institucioni, pa kaluar në procesin e likuidimit në gjendjen e aftësisë paguese.

Ndërsa në rastet kur kemi bashkimin me krijimin e **një shoqërie të re** atë herë prodhohen këto pasoja juridike:

- a) të gjitha aktivet dhe pasivet e shoqërisë objekt i kalojnë menjëherë shoqërisë së re, pavarësisht kërkesave ligjore për kryerjen e formaliteteve të posaçme, të cilat, në çdo rast, kanë efekt deklarativ;
- b) ortakët ose aksionarët e shoqërisë objekt bëhen ortakë ose aksionarë të shoqërisë së re;
- c) shoqëria objekt konsiderohet e prishur dhe nëse shoqëria objekt është shoqëri shqiptare, atëherë ajo çregjistrohet menjëherë nga QKR/QKB-ja, në bazë të parashikimeve të ligjit që rregullon organizimin dhe funksionimin e këtij institucioni, pa kaluar në procesin e likuidimit në gjendjen e aftësisë paguese.²²

V. MBROJTJA E PUNËMARRËSVE.²³

Punëmarrësit janë personat më të rrezikuar nga bashkimi ndërkufitar i shoqërive tregtare. Për të mbrojtur të drejtat e tyre është hartuar një kuadër i tërë ligjor, vendas dhe i huaj me qëllim që të jetë sa më eficient e faktik e jo të mbetet thjesht fiktiv. Të drejtat e punëmarrësve ushtrohen nëpërmjet përfaqësuesve të tyre në organet drejtuese, përfaqësues këta të detyrueshëm sipas ligjit të brendshëm dhe atij evropian.

Në LTSHT përcaktohet se në rastet kur një shoqëri ka më tepër se 50 punëmarrës ata krijojnë Këshillin e Punëmarrësve, me anë të së cilit mbrojnë interesat e tyre. Funksionet e një shoqërie tregtare, e cila ka mbi 20 punëmarrës, por më pak se 50, kryhen nga një përfaqësues, për çdo 10 punëmarrës, i cili zgjidhet me votim të fshehtë nga asambleja e punëmarrësve të shoqërisë. Asambleja e punëmarrësve zgjedh një përfaqësues të ri, për çdo 20 punëmarrës shtesë të shoqërisë. Në çdo rast, këshilli i punëmarrësve nuk mund të ketë më shumë se 30 anëtarë.²⁴ Ky këshill monitoron zbatimin e ligjit dhe të kontratave kolektive si dhe dispozitave të statutit në mënyrë që të mbrojtë sa më efektivisht të drejtat e punëmarrësve. Ai merr informacione mbi veprimtarinë e shoqërisë, si dhe mund të caktojë përfaqësues të tyre në nivele të ndryshme administrimi²⁵ dhe duhet që të raportojë përpara asamblesë së përgjithshme të shoqërisë tregtare për veprimtarinë e tij. Pavarësisht parashikimeve të tilla ligjore zbatimi në praktikë i këtyre

²² Neni 13 i LBNSHT.

²³ Nenet 16-22 të LBNSHT.

²⁴ Neni 19 i LTSHT.

²⁵ Nenet 19-21 të LTSHT.



ALBANIA

Law Journal

ISSN 2523-1774

LAWJOURNAL.AL

Numri 6

Prill 2018

dispozitave mbetet ende i vakët, ku në të shumtën e rasteve më shumë është fiktive dhe formale, duke mos kryer kështu asnjë funksion.

Ndërsa LBNSHT përcakton se nëse shoqëria që formohet nga bashkimi është shqiptare, dispozitat që mbrojnë punëmarrësin janë ato të LTSHT. Por përkrah parashikimeve të ligjit, nëse shoqëritë shqiptare apo ato europiane kanë patur më shumë se 500 punëmarrës, u njihet e drejta që këta punëmarrës të ndikojnë nëpërmjet pjesëmarrjes në nivele të ndryshme administrimi apo nëpërmjet të drejtës së propozimit të anëtarëve të ndryshëm në këto organe.²⁶

Përveç përfaqësimit direktiva²⁷ i njeh të drejtën punëmarrësve të negociojnë me përfaqësuesit e shoqërive për të gjitha pasojat që do të ketë mbi ta bashkimi dhe për gjetjen e gjuhës së përbashkët me qëllim mbrojtjen e të drejtave të tyre. Përfaqësuesit ligjor të shoqërive tregtare janë të detyruar që pas publikimit të projekt marrëveshjes mbi kushtet e bashkimit, të përmbushin të gjitha kushtet për krijimin e organit të posaçëm të negocimit. Organi i posaçëm i negocimit është organ *ad hoc* me kompetenca të reduktuara vetëm në zgjidhjen e këtyre çështjeve.²⁸ Organi i posaçëm i negocimit përbehet nga të paktën 10 anëtarë, që zgjidhen ndërmjet përfaqësuesve të punëmarrësve nga shoqëritë e prekura nga bashkimi ndërkufitar. Në marrëveshje me përfaqësuesit ligjor të shoqërisë ata negociojnë për masën e pjesëmarrjes së punëmarrësve në organizimin dhe funksionim e shoqërisë që rezulton nga bashkimi. Në çdo rast ky organ vendos me shumicën e votave të anëtarëve, ndërsa kur i reduktohen të drejtat punëmarrësve duhet që të vendos me 2/3 e votave të anëtarëve. Ky organ mund të asistohet dhe nga ekspertë dhe të gjitha shpenzimet rëndojnë mbi shoqëritë pjesëmarrëse. Qëllimi i këtij organi është të krijojë një marrëveshje të përbashkët për të rregulluar disa çështje problematike si dhe të vendos për shpërndarjen e mandateve në organet e shoqërisë, apo mënyrën e emërimit të tyre në këto organe. Organit të posaçëm të negocimit pas formimit, i njihet e drejta për t'u informuar dhe konsultuar, si dhe të takohen mes tyre. Ata njihen me rendin e mbledhjes së organeve administrative dhe mbikëqyrëse si dhe kopjet e dokumenteve të dorëzuara në asamblenë e ortakëve ose aksionare.²⁹

Të gjitha palët kanë të drejtë të kenë akses mbi informacionin e shoqërisë.³⁰ Ky informacion mund të aksesohet si nga punëmarrësit ashtu edhe nga aksionerët kërkues dhe kreditorët.

²⁶ Neni 16/2 i LBNSHT.

²⁷ Direktiva 2005/56/KE të Parlamentit European dhe të Këshillit, datë 26 tetor 2005 "Për Bashkimin Ndërkufitar të Shoqërive me Përgjegjësi të Kufizuar". Numri CELEX: 32005L0056, Fletorja Zyrtare e Bashkimit European, Seria L, Nr. 310, datë 25.11.2005.

²⁸ Neni 19 i LBNSHT.

²⁹ Neni 22 i LBNSHT.

³⁰ Neni,23 i LBNSHT.



ALBANIA

Law Journal

ISSN 2523-1774

LAWJOURNAL.AL

Numri 6

Prill 2018

Nëqoftëse ky informacion është sekret atë herë palët janë të detyruara të ruajnë konfidencialitetin e këtyre informacioneve.

VI. PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME

Sigurisht që nëqoftëse Shqipëria do të arrijë të integrohet në Bashkimin Europian, do të ketë shumë lehtësira për zhvillimin e tregtisë. Kjo për shkak se tanimë shoqëritë europiane nuk do të kenë më nevojë të ndjekin procedura të gjata dhe burokratike për investimet e tyre në Shqipëri. Me anë të këtij ligji i hapet rrugë krijimit dhe bashkëpunimit ndërmjet shumë shteteve për të plotësuar nevojat që ato kanë për shkak të mangësive të burimeve apo të të prodhimit e zhvillimit teknologjik.³¹

Një nga përfitimet më të mëdha të këtij ligji është dhe reduktimi i kostove si operacionale ashtu dhe organizative duke gjeneruar më shumë të ardhura dhe financim për këto shoqëri³². Bashkimet e shoqërive në formën e joint venture të përkohshëm që krijohen në Shqipëri si pasojë e koncesioneve apo masterfranchising³³, do i lënë vendin e tyre shoqërive të reja me struktura të mirëcaktuara, të krijuara si rezultat i aplikimit të këtij ligji. Ligji Nr.110/2012 në përgjithësi është një përafrim i direktivës së Bashkimit Europian në qëllim të garantimit të tregut të përbashkët dhe konkurrencës. Edhe pse një ligj akoma i pa vendosur në zbatim është me interes të ndiqet mënyra e zbatimit të tij në të ardhmen si pasojë e integritimit europian të Shqipërisë. Delegimi i një pjese të sovranitetit i hap rrugë miratimit të një sërë aktesh të reja nënligjore dhe praktikës së gjykatës europiane të drejtësisë.³⁴

Tregu i ardhshëm europian dhe Shqipëria do jetë një i vetëm dhe prandaj nevojitet një harmonizim më i detajuar i kësaj direktive dhe jo vetëm një përafrim i thjeshtë në sajë të marrëveshjes së stabilizim-asociimit. Problemet e ardhshme në drejtim të këtij ligji janë *ipso facto*, por një mbrojtje dhe përgatitje e nevojshme që tani më do të bënte punën më të lehtë për organet ligjvënëse dhe sistemin gjyqësor. Gjithashtu tregu i përbashkët ka nevojë për një bashkëpunim të thellë dhe roli i shoqërive vepruese në këtë drejtim do ti krijojë mundësi më të mëdha bashkëpunimi, dhe mundësinë e transferimit të know-how³⁵ në mënyrë që Shqipëria të mos mbesë vetëm prodhuese e vetvetes, por një shtet me ndikim në tregtinë europiane për produktet ku ka burime natyrore të gjera dhe jo-shteruese.³⁶

³¹<https://www.out-law.com/topics/corporate/reorganisations/using-cross-border-mergers-within-groups-of-companies-in-the-eea/>

³²Study on the Application of the Cross-Border Mergers Directive, International Policy Studying, 2013 fq.8.

³³Shoqëri të krijuara si pasojë e kontratës franchising për të përhapur know-how.

³⁴Zajmi,I., *Tregu i Përbashkët Europian* OMBRA GVG, Tiranë 2010, fq.38.

³⁵Tërësia e eksperiencës të fituara nga ana e personave kur ushtrojnë biznesin e tyre.

³⁶<https://jci.cc/ouevents/eukht2017>